

South Eastern Europe



Regional Rural Development Standing Working Group



PRESPA
CROSS-BORDER REGION

Procesverbal i Takimit të 10-të të Grupit të aktorëve
për
Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

23 Qershor, 2015
Hotel Millennium Palace, Ohër

Republika e Maqedonisë

The project is funded by the European Union



Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 10-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 24 antarë të emëruar dhe të rinj të mundshëm për Rajonin e Prespës. Takimi u organizua dhe u facilitua nga Stafii i Njësise së menaxhimit të Projektit me asistencën e Presidentes dhe Zëvendës-Presidentit të grupit të palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar “Prespa”.

Lista e plote e pjesëmarrësve dhe detaje për kontaktet e tyre mund të gjenden në:

ANNEX 1: Lista e pjesëmarrësve të takimit të 10-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 23.06.2015

ANNEX 2: SCAN Lista e pjesëmarrësve të takimit të 10-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 23.06.2015

ANNEX 3: PPP - PPP -EC SWG ABDA 4 Prezantimi i Projektit

Programi i takimit:

Takimit i 10-të i Grupit të aktorëve Për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:30 - 11:00 Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirëseardhjes

11:00 – 11:10 Fjalimi i mirëseardhjes

Z. Boban Ilic, SWG Sekretar Gjeneral

Mr. Goran Mickoski, Zëvendës Shef i Departamentit TLED, Bashkia Ohër

Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”

Z. Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”

11:10 – 11:15 Prezantimi i programit

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për rajonin ndërkufitar “Prespa”

11:15 – 11:35 Arritje të përgjithshme në lidhje me përgatitjet e implementimit të

ABDA në vendet e Ballkanit Perëndimor

Znj. Irena Dzimrevska, SWG Shefe operacionale

11:35 – 12:00 Prezantim i projektit në implementimin e ABDA – faza e 3-të

Arritjet kryesore, aktivitetet e projektit, piketat dhe afatet e përgjithshme kohore

Znj. Irena Dzimrevska, SWG Shefe operacionale



12:00 - 12:30 Pushim kafe

12:30 – 13:00 Aktivitetet e ardhshme në lidhje me implementimin e ABDA në rajonin ndërkufitar “Prespa” – Diskutim për mbështetje të mundshme të programit “Njerëzit për Njerëzit” në rajonin Prespa
Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për rajonin ndërkufita “Prespa”

13:00 – 13:30 Diskutim rreth emerimit të antarëve të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” (afirmimi i antarëve aktuale dhe përfshirja e antarëve të rinj)
Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për rajonin “Prespa”

13:00 – 13:30 Konkluzionet dhe aktivitetet e ardhshme

14:00 - 15:00 Dreka

15:00 Kthimi

Procesverbal i takimit

Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes nga Menaxheri Rajonal për rajonin ndërkufitar "Prespa" Z. Damjan Surlevski, i cili falenderoi pjesëmarrësit për prezencën dhe uroi një bashkëpunim sa më të frutshëm me të gjithë aktorët.

Më pas Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" dhe Z.Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" përshëndetë pjesëmarrësit duke theksuar rëndësinë e konsolidimit të grupit të qëndrueshëm të aktorëve të palëve të interesuara “Prespa” dhe vazhdimin e bashkëpunimit në interes të rajonit Prespa edhe gjatë fazës së 3-të.

Në vazhdim në emër të Bashkisë Ohër, Z. Goran Mickoski, përshëndeti takimin duke theksuar vlerën e jashtëzakonshme që kanë patur këto takime gjatë fazës së 2-të sidomos në kuadër të bashkëpunimit me partnere të ndryshëm për realizimin e aktiviteteve “Njerëzit për Njerëzit”. Ai shprehu, kështu kënaqësinë për përfshirjen në aktivitetet të tilla të rëndësishme për rajonin dhe njëkohësisht optimizimin dhe mbështetjen maksimale institucionale edhe në të ardhmen.

Më pas, Z.Damjan Surlevski prezantoi në detaje programin e takimit duke u ndalur në çdo sesion të programit dhe çështjeve për tu trajtuar.

Sesioni 1



Arritje të përgjithshme në lidhje me përgatitjet e implementimit të ABDA në vendet e Ballkanit Perëndimor

Sesioni nisi me prezantimin e Znj. Irena Dzimrevska, Shefe Operacionale e SWG, e cila pasi përshëndeti grupin për prezencën dhe pjesëmarrjen aktive, bëri një përmbledhje të zbatimit të ABDA gjatë fazës së dytë të projektit duke u ndalur në përshkrimin e aktiviteteve të realizuara. Kështu, pjesëmarrësit u informuan mbi progresin dhe veprimet e ndërmarra, rëndësinë e organizimit të tyre për rajonin, përfshirjen e aktorëve të grupit të palëve të interesuara si edhe mundësitë financiare dhe mbështetjen përmes programeve Njerezit për Njerezit. Gjithashtu ajo prezantoi edhe aktivitetet e realizuara për ngritjen e kapaciteteve dhe realizimin e skemave për grante kryesisht në rajonin Drina-Tara dhe Drina – Sava. Ndërkohë, prezantimi u fokusua edhe në aktivitetet e realizuara për promovimin e rajonit përmes aktiviteteve “Njerezit për Njerezit” si edhe promovimin në panairin Euregia në Gjermani. Gjithashtu gjatë këtij sesi u realizua edhe një prezantim i shkurtër lidhur me funksionimin e Njesisë së Menaxhimit të projektit, strukturës dhe rolit të saj mbështetës për grupin e palëve të interesuara Prespa.

Sesioni 2

Prezantim i projektit në implementimin e ABDA – faza e 3-të. Arritjet kryesore, aktivitetet e projektit, piketat dhe afatet e përgjithshme kohore

Gjatë këtij sesi Znj. Irena Dzimrevska vazhdoi me prezantimin e implementimit të fazës së 3-të duke u ndalur në mbështetjen e zhvillimit rural rajonal nga Grupi Permanent i Punës (SWG) në Ballkanin Perëndimor. Në vazhdim ajo u ndal në prezantimin e objektivave kryesorë të projektit “Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimi i balancuar territorial i vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin e integrimit në BE”.

Qellimi kryesor i projektit është fuqizimi i bashkëpunimit rajonal midis institucioneve dhe palëve të interesuara në bujqësi dhe sektorin e ushqimit si edhe lehtësimi i procesit të zhvillimit të balancuar territorial i vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin e integritit në BE. Gjithashtu objektivi kryesor i projektit është të fuqizojë rrjetëzimin dhe bashkëpunimin midis institucioneve publike dhe palëve të interesuara si edhe strukturave të tjera relevante rajonale me qëllim procesin e integritit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të tjera potenciale në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Gjatë prezantimit u theksua edhe qasja e përgjithshme e projektit duke u ndalur tek fokusi i përgjithshëm i cili do të lidhet me rritjen e kapaciteteve të grupit të palëve të interesuara dhe mbështetjen për aplikimin në thirrje për projekt propozime. Piketa të tjera të përmendura ishin zinxhirat e shkurtër të vlerave, mos financimi i granteve gjatë fazës së tretë, analizimi i situatës në tre rajone të tjera ndërkufitare si edhe mbështetja e SWG në dialogun politik. Kështu, në vazhdim të prezantimit Znj. Dzimrevska detajoi edhe aktivitetet e mundshme nën implementimin e projektit për secilën piketë.

Në përfundim të prezantimit u ritheksa edhe njëherë roli i Zyrës së Njesisë së Menaxhimit të Projektit duke u ndalur tek lehtësimi i procesit në përgatitjen e



projekteve nga grupi i palëve të interesuara sipas qasjes ABD, gjetjen e donatorëve potencialë, menaxhimin e aktiviteteve në rajonin ndërkufitar si edhe zhvillimin e njohurive rreth mbështetjes së instrumentave ekzistues me qëllim mbështetjen e projekteve në rajon.

Në diskutimet e ndryshme të realizuara gjatë këtij sesiioni nga aktorët pjesëmarrës u theksua rëndësia e bashkëpunimit midis antarëve të grupit në shkëmbimin e informacionit, ideve me qëllim thithjen e sa më shumë fondeve. Kështu u theksua që vetë grupi duhet të caktojë kriteret e suksesit dhe se Zyra e Njesisë për Menaxhimin e Projektit të ketë një rol facilitues dhe antarët e grupit të ndërmarrin hapa në grup dhe të jenë aktivë.

Gjithashtu komente të tjera gjatë diskutimit u lidhën edhe me ndryshimet administrative territoriale që do të organizohen në Shqipëri duke theksuar edhe zhvillimin e dinamikave të reja edhe brenda grupit të palëve të interesuara në përfshirjen e aktorëve të rinj.

Në vazhdim të diskutimeve u theksua edhe rëndësia e bashkëpunimit në aplikimin për projekt propozime të ndryshme të programe CBC, nxitjen e parteriteve, rritjen e kapaciteteve, organizimin e tryezave të rrumbullakëta si edhe zhvillimeve takimeve direkte me partnerë potencialë për zhvillimin e ideve për aplikime.

Gjithashtu në vazhdim u kërkua që Zyra e Njesisë së Menaxhimit të Projektit të mund të bashkëpunojë me antarë të grupit të palëve të interesuara duke sugjeruar krijimin e një database lidhur me projektet e realizuara në rajon me qëllim mos përsëritjen e projekteve të njëjta dhe informimin e aktorëve të ndryshëm në rajon të interesuar për projekt propozime.

Gjithashtu gjatë diskutimit o konkludua se Zyra e Njesisë së Menaxhimit të Projektit do të mbështesë idetë dhe facilitojë iniciativat e aktorëve në rajon për gjetjen e objektivave dhe realizimin e projekteve të përbashkëta. Gjithashtu edhe ndryshimi territorial në Shqipëri dhe zgjerimi i strukturave të reja do të angazhojë Zyrën e Njesisë së Menaxhimit të Projektit të kontaktojë me kryetarët e Bashkive me qëllim pjesëmarrjen dhe ndërlidhjen në gjetjen e parteriteve. Gjithashtu SËG do të sigurojë edhe ndërlidhjen në nivel politik i cili realizohet çdo vit në nivel ministror dhe pse jo edhe lobimin për financimin e qasjes ABDA.

Sesioni 3

Aktivitete të ardhshme në lidhje me implementimin e ABDA në rajonin ndërkufitar “Prespa” – Diskutim për mbështetje të mundshme të programit “Njerëzit për Njerëzit” në rajonin Prespa

Në fillim të këtij sesiioni Z. Damjan Surlevski bëri një prezantim të kontakteve të vendosura me partner, donatorë potencialë që veprojnë në rajon duke u ndalur tek mundësitë dhe idetë konkrete të deritanishme për aktivitete të mundshme. Kështu ai prezantoi idenë e realizimit të festivalit të verës dhe djathit në Ohër për zgjerimin e promovimit të produkteve të rajonit si edhe idenë e turit ciklistik të Galicicës. Më pas Z. Damjan Surlevski ftoi pjesëmarrësit në diskutim të hapur rreth mbështetjes së mundshme të programit “Njerëzit për Njerëzit”.



Në diskutimet e realizuara mbi sesionin e tretë antarë të grupit të palëve të interesuara theksuan se programet Njerëzit për Njerëzit janë një mundësi shumë e mirë aktiviteteve dhe se ideja e turit ciklistik të Galicicës është një mundësi e mirë në promovimin e zonës ndërkufitare duke u mbështetur edhe nga partner nga zona Shqiptare. Kështu, u sugjerua që të ftohen agjensi private nga të dy anët e rajonit, të cilat pasi të jenë njohur dhe ti kenë shijuar nga afër këto resurse natyrore të mund të ofrojnë paketa konkrete dhe ti shesin tek turistët.

Gjithashtu rreth aktiviteteve në të ardhmen u sugjerua rëndësia e zhvillimit të paketave të përbashkëta turistike me operatorë Maqedonas duke lehtësuar ndërlidhjen me operatorët privatë nga të dy vendet. Gjithashtu u sugjerua që pas krijimit të paketave turistike të përbashkëta të organizohen takime me kryetarë të bashkive në rajon me qëllim sensibilizimin dhe njohjen e problematikave, nevojave, pse jo edhe financimin dhe gjetjen e donatorëve në rajonin ndërkufitar.

Gjithashtu në përfundim të diskutimeve u sugjerua që ide të tilla mund të zhvillohen edhe në projekte më të mëdha sesa programi “Njerëzit për Njerëzit” dhe se krahas këtyre ideve nuk mund të harrojmë edhe eventet e përbashkëta promovuese për rajonin.

Sesioni 4

Diskutim rreth emërimit të antarëve të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” (afirmimi i antarëve aktualë dhe përfshirja e antarëve të rinj)

Gjatë këtij sesioni Znj. Etleva Thimo pasi theksoi rëndësinë e funksionimit të grupit të palëve të interesuara të rajonit Prespa dhe ideve konkrete për zhvillimin e iniciativave të përbashkëta për partneritet, ftoi pjesëmarrësit në një diskutim të hapur rreth sugjerimeve për përfshirjen e antarëve të rinj dhe atyre që kanë qënë inaktivë për shumë kohë.

Gjatë diskutimit u sugjerua që të përfshihen edhe me shumë antarë të interesuar nga fusha e biznesit. Gjithashtu u sugjerua që përmes një ankete të dërguar në mënyrë elektronike të mund të ftoheshin operatorë të interesuar për bashkëpunim. Ndërkohë u sugjerua që antarë të grupit të palëve të interesuara sipas informacioneve dhe identifikimeve të tyre të mund të komunikojnë me zyrën e njësisë së menaxhimit të projektit duke sugjeruar aktorë të tjerë potencialë që mund të bëhen pjesë e grupit. Gjithashtu edhe pas ndarjes së re administrative territoriale përfaqësues të tjerë nga Bashkitë mund të jenë antarë potencialë të rëndësishëm.



Sesioni 5

Konkluzione dhe mbyllja e takimit

Në sesioni e fundit u dhanë konkluzionet si mëposhtë:

- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” dhe SWG do të shërbejë si një pikë informative ku antarët e grupit (SHG) të marrin informacion për thirrje për projekt propozime e programe si edhe do të mbështese në përgatitjen e aplikimeve dhe partnerëve për programin CBC dhe realizimin e projekteve të përbashkëta në rajon;
- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” do të bashkëpunojë me antarë të grupit të palëve të interesuara për krijimin e një database lidhur me projektet e realizuara në rajon me qëllim mos përsëritjen e projekteve të njëjta dhe informimin e aktorëve të ndryshëm në rajon të interesuar për projekt propozime.
- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” do të bashkëpunojë me grupin e palëve të interesuara për krijimin e një bazë të dhënash në lidhje me të gjitha ngjarjet dhe manifestimet që janë organizuar në rajon. Qëllimi kryesor është çdo anëtar të të njihet me ngjarjet dhe mundësinë e zgjerimit të tyre nga niveli lokal në nivel rajonal dhe përfshirjen më të madhe të anëtarëve SHG në këto evente.
- Gjithashtu do të lehtësohen takime dhe kontakte me biznesin, operatore turistike me qëllim gjetjen e objektivave të përbashkëta dhe krijimin e paketave të integruara turistike;
- Nëse është e mundur, aktivitete shtesë për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me hartimin e projekteve dhe menaxhimin e projekteve, duhet të planifikohen dhe të organizohen për anëtarët SHG;
- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” do të vazhdojë të mbështesë idetë dhe do të ndihmojë në koordinimin e aktiviteteve potenciale (turi ciklistik Galicica, paketat e integruara turistike, festivali i verës dhe i djathit, festivali i molles) që mund të mbështeten nga programi “Njerëzit për Njerëzit”;
- Në vazhdimësi të takimeve zyra për menaxhimin e programit “Prespa” do të kontaktojë me Bashkitë e reja që do të krijohen pas ndarjes së re administrative territoriale në Shqipëri, si dhe do të ftohen të marrin pjesë në takimet e grupit të palëve të interesuara (SHG) me qëllim njohjen më nga afër të punës së grupit në rajonin Prespa;



- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” do të dërgojë formularin për secilin anëtar veç e veç i cili duhet të plotësohet me informacion në lidhje me projektet e zbatuara, aktivitete të planifikuara dhe fushën aktive të interesit të secilit anëtar SHG. Kjo do të përshpejtojë procesin e krijimit të partneriteteve për thirrjet e ardhshme për projekte;
- Në bashkëpunim me antarë të grupit të palëve të interesuara do të bëhen identifikime për përfshirjen e aktorëve të tjerë potencialë (preferohen nga OJQ që punojnë në sektorin e turizmit ose sektore të zhvillimit të qendrueshëm të biznesit), ndërkohë që të tjerë që kanë qënë inaktivë për një kohë të gjatë, ose kanë ndërruar pozicione të mos kontaktohen në të ardhmen ose do u kërkohej të bëjnë zëvendesimet e duhura sipas organizatës/institucionit perkates;

Përgatiti:

Etleva Thimo

Koordinatorë Rajonale

Rajoni Ndërkufitar Prespa

